NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A.
PUBLIC HOUSING ENTERPRISE J.S.C.

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A Prishtinë, shpall:

K O N K U R S

Pozita: Depoist
Lloji i vendit të punës (orari i plotë/jo i plotë): Me orar të plotë
Numri i kryerësve: 1 (një)
Raportimi: Udhëheqësit të Shërbimeve të Brendshme

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Është përgjegjës për materialin e imët dhe harxhues të depos;
- Bën pranimi e mallrave, sistemimin e tyre në vend të caktuar dhe shënjimin e tyre në harmoni me procedurat e menaxhimit të depos;
- Mirëmban depon në gjendje të rregullt;
- Bashkëpunon me divizionin e kontabilitetit;
- Kryen dhe punë të tjera të cilat i kërkohen nga Udhëheqësi i Divizionit të Shërbimeve të Brendshme.
- I raporton Udhëheqësit të Divizionit të Shërbimeve të Brendshme;

Kualifikimi dhe kushtet tjera të veçanta:

- Të ketë të kryer shkollën e mesme;
- Së paku një (1) vit përvojë pune profesionale;
- Njohje shumë e mirë e programeve të MS Office;
- Aftësi të shkëlqyera të komunikimit;

Për plotësimin e kësaj pozite për persona me aftësi të kufizuara

Pozita: Punëtor i mirëmbajtjes
Lloji i vendit të punës (orari i plote/jo i plotë): Me orar të plotë
Numri i kryerësve: 1 (një)
Raportimi: Udhëheqësit të Divizionit të Mirëmbajtjes

Detyrat dhe përgjegjësitë*:*

- Ndihmon në kryerjen e riparimeve të ndërtesave, pajisjeve ose sistemeve;
- Kryen ngjyrosjen e mureve;
- Ndihmon në mirëmbajtjen e ndërtesave, pajisjeve ose sistemeve;
- Riparon ose zëvendëson pajisje të ndryshme, siç janë dyert dhe dritaret;
- Ndihmon në renovimin dhe dekorimin e objekteve brenda dhe jashtë;
- T'u përgjigjet në mënyrë efikase kërkesave emergjente të mirëmbajtjes;
- Të bëjë vlerësimin për furnizim me pjesë dhe t'i porosisë ato në bazë të autorizimit;

- Të bëjë kontrollin ditor, javor dhe mujor të ndërtesave të identifikuara

Kualifikimi dhe kushtet tjera të veçanta*:*

- Të ketë çertifikatë të kryerjes së shkollës speciale;
- Përvojë pune profesionale, e dëshirueshme;

***Procedura e Konkurrimit* :** Kandidati-ja duhet t'i dorëzoi këto dëshmi:

- CV-në;
- Dëshminë e Kualifikimit Profesional;
- Dëshminë për Përvojën e Punës;
- Kopjen e Lejes së Njoftimit dhe
- Referenca të tjera që janë të rëndësishme për këtë vend pune**.**

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: **Ndërmarrja Publike Banesore - SHA në Prishtinë, Bulevardi "Bill Clinton", p.nr., Prishtinë** ose përmes e-mail-it zyrtar: **burimet.njerezore@npbanesore.com**. Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe e-mail adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë. Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen. **Konkursi është i hapur nga data 06.12.2016 – 20.12.2016, ora 16:00.**